



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.20, datë 31.01.2022

**PËR CAKTIMIN E MASËS DISIPLINORE NDAJ MAGJISTRATES BELINA ZENELI
(KRYEMADHI), ME DETYRË PROKURORE NË PROKURORINË PRANË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DIBËR**

Bazuar në nenin 148, pika 2, germa "a", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenin 102 pika 1 germat "ç", "d"; nenin 105, pika 1, shkronja "dh" dhe nenin 111 pika 1, germa "b", të ligjit Nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", i ndryshuar; në nenin 189, pika 1, germa "a" të ligjit Nr.115/2016, "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar; në nenin 104 të Ligjit Nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë" dhe Rregulloren "Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve", miratuar me Vendimin Nr.260, datë 17.11.2020 të KLP-së, me propozim të Komisionit të Disiplinës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës Nr.2346 prot., datë 29.10.2021, të paraqitur nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedim disiplinor ndaj prokurores Belina Zeneli (Kryemadhi), për shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, parashikuar nga neni 148/d, pika 2, germa "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1 germa "ç", "d"; neni 105, pika 1, shkronja "dh" dhe neni 111 pika 1, germa "b", të ligjit Nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
2. Dhënien e masës disiplinore "Shkarkim nga detyra" për magistraten Belina Zeneli (Kryemadhi), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;



3. Pezullimin e përfitimit të pagës në masën 50 %, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit, derisa vendimi të marrë formë të prerë.
4. Vendimi i arsyetuar me shkrim, i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe zj. Belina Zeneli (Kryemadhi) brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shpalljes.
5. Të njoftohet për zbatimin e këtij vendimi Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë si dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese brenda afatit të përcaktuar nga neni 50, pika 4 e Ligjit Nr.8577, datë 10.02.2000 i ndryshuar, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR
LUDOVIK DODAJ**

**ANËTAR
ZEQIR HODA**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**